

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-97/13

**Prishtinë,
12 nëntor 2013**

Në çështjen juridike të

R.V

Paraqitësja e kërkesës/Pala ankuese

Kundër

K.J

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Esma Erterzi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/159/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA47114), të datës 6 qershor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më nëntor 2013, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/159/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA47114), i datës 6 qershor 2012.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 1 nëntor 2007, R.V ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar ri-posedimin e një prone-banese që gjendet në rrugën e Goleshit në Prishtinë me sipërfaqe prej 68.03 m². Paraqitësja e kërkesës ka deklaruar se ajo është e pakënaqur me vendimin e Drejtoratit për Çështje Pronësore Banesore (DÇPB) në lëndën nr. DS002177 dhe ka kërkuar “një vendim mbi pronësinë e pronës në fjalë”.

Në mbështetje të kërkesës së saj, znj V. ka paraqitur dokumente të shumta, mes tjerash edhe një vendim të nxjerrë me datën 23 shkurt 1966 nga Komiteti Administrativ i Republikës Socialiste të Serbisë për ndarjen e një banese në Beograd H.F; kontratën e qiradhënies të vitit 1966 për dhënien e së drejtës së shfrytëzimit të së njëjtës banesë në favor të së njëjtit person; kontratën e shitblerjes së vitit 1992 për të njëjtën banesë me H.F si blerës; vendimin e Komisionit për ndarjen e banesave dhe huave të Republikës Socialiste të Serbisë të vitit 1975 për dhënien e banesës së kontestueshme në Prishtinë në shfrytëzim të përkohshëm (zyrtar) H.F; urdhrin e vitit 1991 të Sekretariatit për Urbanizëm dhe Çështje Banesore për dëbimin e H.F nga e njëjta banesë; certifikatën e vitit 2002 të lëshuar nga Ndërmarrja Publike Banesore në Beograd se banesa që i është shitur H.F në vitin 1992 i përkiste më parë Qeverisë së Serbisë; vendimin e Komitetit për Banim të Organeve Krahinore të vitit 1991 për dhënien në shfrytëzim të banesës së kontestueshme në Prishtinë paraqitëses aktuale të kërkesës, R.V.

Kërkesa është regjistruar me numrin KPA47114.

Më 30 janar 2008, zyrtarët e AKP-së kanë bërë njoftimin e pronës duke vendosur një shenjë njoftuese në derën e banesës.

Në të njëjtën datë, pala përgjegjëse në kërkesë K.J ka paraqitur njoftim për pjesëmarrje, duke kërkuar të drejtën pronësore ndaj banesës në fjalë.

Për të mbështetur kërkesën e saj, pala përgjegjëse në kërkesë ka paraqitur dokumente lidhur me ndarjen dhe blerjen e kësaj banese nga H.F.

Dokumentet e paraqitura nga të dy palët janë verifikuar pozitivisht nga AKP-ja.

Më 6 qershor 2012, me vendimin KPPC/D/R/159/2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore e ka hedhur poshtë kërkesën si lëndë të vendosur ose *res judicata*. KKPK-ja ka dhënë arsyetimin se e njëjta kërkesa ka qenë e regjistruar në KKPB (Komisioni për Çështje Pronësore Banesore) dhe ishte vendosur sipas vendimit të plotfuqishëm HPCC/REC/56/2006 të datës 18 shkurt 2006.

Komisioni ka vërejtur se paraqitësja e kërkesës kishte paraqitur më herët kërkesën e kategorisë C në DÇPB për të njëjtën pronë sipas kërkesës me numër DS002177. Njëkohësisht, pala përgjegjëse në kërkesë në KKPK po ashtu kishte paraqitur kërkesë në DÇPB – kërkesën e kategorisë A me numër DS001096. Fillimisht, DÇPB-ja me vendimin HPCC/D/195/2005A&C e kishte miratuar kërkesën e kategorisë C. Pastaj është bërë kërkesë për rishqyrtim dhe DÇPB-ja kishte nxjerrë vendimin HPCC/REC/56/2006 me anë të së cilit e kishte anuluar vendimin e mëhershëm, duke miratuar kërkesën e kategorisë A me rikthim e të drejtës pronësore pronës dhe duke i dhënë të drejtë kompensimi paraqitësit të kërkesës së kategorinë C. Prandaj, KKPK-ja e ka konsideruar lëndën si *res judicata*.

Më 19 mars 2013, vendim i është dorëzuar si paraqitësit të kërkesës (këtej e tutje: pala ankuese) ashtu edhe palës përgjegjëse në kërkesë (këtej e tutje: pala përgjegjëse në ankesë. Pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme me 19 prill 2013.

Pala ankuese e kundërshton vendimin e ankimuar mbi bazën se kjo nuk është *res judicata*.

Sipas mendimit të saj, ekzistojnë dy kërkesa të ndryshme në këtë çështje – njëra për kthim të së drejtave të banimit dhe tjetra për kthim të pronësisë dhe se këto të dyja nuk e përjashtojnë njëra tjetrën. Vendim i marrë për kthim të së drejtave të banimit nuk e përjashton mundësinë e fillimit të një procedure në të cilën gjykata do të vendoste rreth të drejtës pronësore ndaj të njëjtës pronë.

Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që të ndryshojë vendimin e KKPK-së dhe të pranojë kërkesën e saj. Ajo gjithashtu kërkon nga gjykata që ta lirojë atë nga pagesa e taksave gjyqësore për shkak të faktit se ajo është një person i zhvendosur dhe ndodhet në gjendje të vështirë financiare. Ajo nuk është në gjendje të paguaje taksat. Kjo pagesë do të vështirësonte ekzistencën e familjes së saj. Ajo nuk ka paraqitur prova në lidhje me këtë.

Pala përgjegjëse në ankesë nuk është përgjigjur në ankesë.

Arsyetim ligjor:

Ankesa është e pranueshme ngase është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore sipas dispozitave të nenit 194 të LPK-ës, Gjykata Supreme gjeti se ankesa është e pabazuar.

Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja ka vepruar drejtë kur ka vendosur që ta hedhë poshtë kërkesën e R.V për shkak të çështjes së vendosur apo *res judicata*. Kërkesa e palës ankuese ishte shqyrtuar dhe vendosur me vendimin e plotfuqishëm dhe të formës së prerë HPCC/REC/56/2006.

Me këtë vendim të KKPB-së, palës përgjegjëse në ankesë i është pranuar e drejta pronësore, ndërsa kërkesa e palës ankuese për ri-posedim ishte refuzuar por asaj i është pranuar e drejta e kompensimit.

Është e vërtetë se *res judicata* formohet vetëm në lidhje me çështjen lëndore të kërkesës – kufijtë objektiv të *res judicata* dhe ndaj palëve që kanë marrë pjesë në procedurë (me disa përjashtime kur *res judicata* mund të ndikojë edhe tek palët e treta, që në çështjen aktuale nuk është relevante) – këta janë kufijtë subjektiv të *res judicata*. Nuk ekziston ndonjë argument lidhur me atë se cilat janë palët në rastin aktual – ato janë të njëjta me ato në lëndën para KKPB/DÇPB-së. Megjithatë, paraqitësja e kërkesës pretendon se çështja lëndore e rastit tani është e ndryshme nga çështja lëndore e vendosur në procedurën e mëhershme. Ajo pohon se KKPB/DÇPB-ja është dashur të vendos për të drejtën e shfrytëzimit, ndërsa tani çështje lëndore është vetë e drejta pronësore.

Gjykata gjen se ky pretendim është i gabuar. Nga vendim i KKPb-së është e qartë se ka qenë në pyetje e drejta pronësore ndaj pronës që ishte vendosur si *res judicata* e jo vetëm e drejta e shfrytëzimit të palëve. Në procedurën e mëhershme, KKPb-ja me vendimin HPCC/REC/56/2006 e ka njohur paraqitësen e kërkesës së kategorisë A si pronare të pronës në fjalë. Paraqitësja e kërkesës së kategorisë C – (që në fakt është ankues) i ishte njohur e drejta e kompensimit që do të paguhej nga DÇPB (Drejtorati për Çështje Pronësore Banësore). Kjo nënkupton se e drejta pronësore i ishte refuzuar paraqitëse së kërkesës së kategorisë C. Kështu që, e drejta pronësore që tashmë është refuzuar nuk mund të jetë objekt i rishqyrtimit në procedurën aktuale.

Është e vërtetë së paraqitëses së mëhershme e kërkesës së kategorisë A (e cila tani është palë përgjegjëse në ankesë) i ishte njohur e drejta pronësore dhe i ishte kërkuar që të paguajë një shumë të caktuar në DÇPB. Paraqitësja e kërkesës së kategorisë C kishte të drejtë që të kërkonte ri-posedimin në rast se paraqitësja e kërkesës së kategorisë A nuk e paguan shumën në fjalë në DÇPB (pika c e dispozitivit të vendimit të rishqyrtimit). Megjithatë, se a e ka paguar shumën në fjalë paraqitësja e kërkesës së kategorisë A dhe se a e ka pranuar kompensimin paraqitësja e kërkesës së kategorisë C nuk e ndryshon faktin se kontesti pronësore ndërmjet këtyre të dyjave nuk mund të jetë objekt i procedurës gjyqësore pasi që KKPb-ja përjashton të drejtën për kërkesë të njëjtë – kjo formon *res judicata*.

Në përputhje me nenin 166 të LPK-së, të zbatuar mutatis mutandis sipas nenit 13.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, parashihet se nuk lejohet gjykimi i ri në mes palëve të njëjta për çështjen juridike, për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë, siç është rasti konkret.

Vendimi ankimor nuk përmban ndonjë gabim të rëndë apo moszbatim serioz të së drejtë materiale dhe procedurale.

Në bazë të asaj që u cek me lartë, në pajtim me nenin 13.3.c të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe nenin 166 par 2 të LPK-ës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Esma Erterzi , Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it